



03 TETOR 2024



Në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, u organizua ceremonia e betimit të magjistratëve, profili “gjyqtar” të cilët kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2023-2024.

32 gjyqtarët e rinj, të sapo emëruar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, i shtohen kështu trupës së gjyqtarëve që ushtrojnë funksionin në gjykatat e vendit.

Magjistratët e rinj si dhe personalitetet e pranishëm në këtë event publik, u përshëndetën nga zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi si dhe nga kryetari i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, z. Klodian Kurushi, të cilët e cilësuan ditën në fjalë të rëndësishme për gjyqësorin shqiptar në drejtim të rritjes së efikasitetit, cilësisë dhe forcimit të besimit te publiku.

Gjatë fjalës së tij z. Ilir Rusi ndër të tjera vuri theksoi se: “Misioni kryesor dhe i vetmi i punës suaj është dhënia e drejtësisë. Por drejtësia nuk jepet gjithmonë në lidhje me njohuritë tuaja profesionale sepse ato zhvillohen më tej në mënyrë të vazhdueshme, por drejtësia duhet dhënë nga njerëz me integritet, në këtë rast duhet dhënë nga magjistratë gjyqtarë me integritet, qoftë integritet personal ashtu edhe profesional.”

Ceremonia vijoi me betimin e gjyqtarëve z. Xhulio Doku, z. Boiken Bendo, z. Delvijot Llusha, znj. Irma Cacaj, z. Ertit Meçaj, znj. Elira Hroni, znj. Erola Tarelli, z. Bevil Beqiraj, znj. Aurora Tusha, znj. Iva Bregasi, znj. Amantja Levanaj, znj. Eni Naqellari, z. Uran Korra, znj. Teftë Khanari, znj. Anisa Xake, z. Enri Rista, z. Renis Bega, znj. Irida Barkaj, znj. Besmira Arshiaj, znj. Matilda Çela, z. Ervis Koxhaj, znj. Megi Anxhela Muhaj, znj. Eda Gjovari, znj. Orinda Lloshi, z. Mexhit Doçi, znj. Esmeralda Shehu, znj. Flutura Çuko, znj. Arxheina Shkopi, znj. Ermira Bushi, znj. Dorinela Nikolli, z. Suzan Bushi, znj. Valjona Haxhiraj, sipas tekstit: “Betohem solemnisht se gjatë kryerjes së detyrës do t’i qëndroj kurdoherë besnik Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjeve në fuqi dhe do të respektoj rregullat e etikës profesionale”.

22 TETOR 2024

Këshilli deklaroi mbarimin e mandatit dhe përfundimin e qëndrimit në detyrë të anëtares së Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami dhe zëvendësimin e saj me anëtares më të re, znj. Violanda Theodori, e zgjedhur nga Kuvendi i Shqipërisë si përfaqësuese e shoqërisë civile.

Duke qenë se znj. Llagami mbante funksionin e kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor, me përfundimin e mandatit të saj, Këshilli në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi vendosi zgjedhjen e z. Ilir Rusi, Kryetar të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Gjatë kësaj mbledhjeje, Këshilli vendosi zgjedhjen me shumicë votash të znj. Yllka Rupa, në funksionin e zëvendëskryetares të Këshillit të Lartë Gjyqësor.



01 NËNTOR 2024



Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi priti në ambientet e Këshillit Ambasadorin e Delegacionit të Bashkimit Europian, z. Silvio Gonzato.

Gjatë këtij takimi përshëndetës, z. Gonzato inkurajoi z. Rusin në funksionin e Kryetarit, për të vijuar me nismat e ndërmarra nga Këshilli në drejtim të rritjes së cilësisë dhe efikasitetit në drejtesi.

Po ashtu takimi pati në qendër të diskutimeve gjetjet e Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë, si edhe adresimin e rekomandimeve nga ana e Këshillit.

Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi, falenderoi z. Gonzato për mbështetjen e deritanishme si edhe u angazhua për të bashkëpunuar më tej, veçanërisht në sfidat dhe problematikat me të cilat përballlet gjyqësori, reflektuar edhe nga Progresi Raporti.

08 NËNTOR 2024

Gjatë datave 3 – 7 Nëntor 2024, Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi, dhe anëtarët e tij morën pjesë në një vizitë studimore në Këshillin Gjyqësor Spanjoll. Kjo vizitë u organizua në kuadër të projektit të Bashkimit Evropian “EU4Justice” dhe në takimet e zhvilluara gjatë kësaj vizite ishte i pranishëm edhe z. Álvaro Renedo Zalba, Ambasadori i Mbretërisë së Spanjës në Shqipëri.

Qëllimi primar i vizitës studimore ishte forcimi i kapaciteteve dhe rritja e efikasitetit të Këshillit përmes shkëmbimit të eksperiencave dhe ndarjes së praktikave më të mira të punës me institucionin homolog.

Në funksion të këtij qëllimi, u zhvilluan takime me përfaqësues të Këshillit Gjyqësor Spanjoll në Madrid, Gjykatën e Lartë si dhe përfaqësues të njëjësive të ndryshme, ndër të cilat: Shërbimin e Trajnimit të Vazhdueshëm, Inspektimit Gjyqësor, Ndhmës së Qytetarëve si dhe Fondacionin Ndërkombëtar dhe Ibero-Amerikan për Administratën dhe Politikën Publike (FIAP). Vizita u finalizua me takimin e organizuar në Shkollën e Magjistraturës, me seli në Barcelonë.

Kjo vizitë, ndër të tjera, shërbeu edhe si një platformë për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe dialogut midis organeve gjyqësore të Shqipërisë dhe Spanjës, sidomos në kontekstin e hapjes së negociatave për anëtarësim të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.



12 NËNTOR 2024

Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi, mirëpriti në ambientet e Këshillit, vëzhguesit ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM), z. Ferdinando Buatier de Mongeot dhe znj. Elka Ermenkova.

Gjatë këtij takimi përfaqësuesit e ONM përgëzuan z. Rusi për detyrën e re si Kryetar i Këshillit si dhe vlerësuan kontributin e deritanishëm të Këshillit të Lartë Gjyqësor veçanërisht, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar.

Takimi u zhvillua në kuadër të forcimit të bashkëpunimit institucional mes KLGJ dhe ONM duke i paraprirë transferimit të kompetencave të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit pranë KLGJ-së, për shkak të përfundimit të mandatit të tij në dhjetor 2024.

Në përfundim të takimit, palët u angazhuan në vijimin e mëtejshëm të adresimit të sfidave dhe problematikave të sistemit gjyqësor në kuadër të reformës në drejtësi.



12 NËNTOR 2024

Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi, si edhe anëtarët e Këshillit pritën në një takim punë znj. Nancy VanHorn, të ngarkuarën me punë të Ambasadës Amerikane, në Tiranë.

Gjatë këtij takimi, znj. VanHorn i përcolli z. Rusi përgëzime për funksionin e Kryetarit të Këshillit dhe e garantoj për mbështetjen e SHBA në vijimin e reformave të ndërmarra nga Këshilli, që kanë si synim një gjyqësor të pavarur, efikas, transparent dhe llogaridhënës.

Të pranishmit u angazhuan në diskutime në lidhje me prioritetet kryesore të Këshillit siç janë vijimi me prioritet i procesit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve, në funksion të ngritjeve në detyrë, si edhe plotësimi i vakancave përmes mekanizmave ligjore. Po ashtu të pranishmit diskutuan mbi zbatimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura, në gjykatat me ngarkesën me të theksuar si dhe nevojën për ndërveprim edhe me aktorë të tjerë, me qëllim vënien në jetë të masave të parashikuara nga kjo strategji.

Në përfundim të takimit, të pranishmit u angazhuan për një bashkëpunim të mëtejshëm, në lidhje me çështjet kryesore në agjendën e Këshillit, që lidhen kryesisht me plotësimin e vakancave dhe reduktimin e backlog-ut.



15 NËNTOR 2024

Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi, shoqëruar nga Drejtori i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit, mori pjesë në seancën dëgjimore për shqyrtimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2025”, të mbajtur para Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Kryetari i KLGJ-së mbajti një prezantim në lidhje me nevojat buxhetore për sistemin gjyqësor, të përkthyer në kërkesa buxhetore për projekt –buxhetin e vitit 2025. Z. Rusi gjatë fjalës së tij theksoi se nevojat më të mëdha për mbështetje buxhetore vijnë të mbeten ato për infrastrukturën ndërtimore të gjykatave, si edhe për teknologjinë e informacionit.



19 NËNTOR 2024

Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi, priti në një takim pune në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Drejtorin e Shkollës së Magjistraturës, z. Arben Rakipi, shoqëruar nga z. Sokol Berberi, Përgjegjës i Programit të Formimit Fillestar, z. Vangjel Kosta, Përgjegjës i Programit të Formimit Vazhdues dhe znj. Borana Mustafaraj, Këshilltare Akademike.

Gjatë këtij takimi u diskutuan çështje të bashkëpunimit të përbashkët, siç janë përmirësimi i trajnimit fillestar për kandidatët magjistratë si edhe atij profesional vazhdues për magjistratët gjyqarë, me synim forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve në sistemin gjyqësor.

Z. Rusi theksoi rolin e rëndësishëm që ka Shkolla e Magjistraturës në formimin profesional të gjyqtarëve, ndihmësve ligjorë si edhe administratës gjyqësore. Forcimi i bashkëpunimit mes dy institucioneve, është i rëndësishëm për rritjen e cilësisë dhe efijencës në gjyqësor, në shërbim të interesit publik.

Nga ana tjetër, z. Rakipi shprehu gadishmërinë e Shkollës që në koordinim me Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe partnerët mbështetës, të mund të ofroj standardet më të larta në formimin e magjistratëve.



21 NËNTOR 2024

Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor z. Ilir Rusi priti në një takim pune në ambientet e Këshillit, z. Arturo Valdés dhe z. Arben Lila, përfaqësues të projektit “EU4Justice”.

Ky takim u fokusua në diskutimin e planit të punës së projektit “EU4Justice”, i cili duhet të ketë si objektiv kryesor adresimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të Progres Raportit të Komisionit Evropian për vitin 2024, në lidhje me pushtetin gjyqësor.

Të pranishmit u dakordësuan për vijimin e bashkëpunimit, me qëllim që prioritetet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, në lidhje me çështjet e konfliktit të interesit, vlerësimin etik dhe profesional si dhe rritjes së efijencës, të gjejnë reflektim të plotë në planin e punës së projektit.



21 NËNTOR 2024

Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi priti në ambientet e Këshillit, përfaqësues të Ambasadës Britanike në Tiranë. Temë kryesore e diskutimit mes të pranishmëve ishte zbatimi i partneritetit gjyqësor iniciuar mes Shkollës së Magjistraturës së Shqipërisë dhe Zyrës Gjyqësore të Anglisë dhe Uellsit. Ky partneritet synon forcimin e kapaciteteve të gjyqësorit shqiptar, përmes shkëmbimit të eksperiencave me gjyqtarë dhe profesionistë të së drejtës të Mbretërisë së Bashkuar.

Z. Rusi falenderoi përfaqësuesit e Ambasadës Britanike për mbështetjen e ofruar dhe vlerësoi mundësinë e këtij partneriteti në kuadër të avancimit të mëtejshëm të kapaciteteve profesionale të trupës gjyqësore. Gjatë fjalës së tij, z. Rusi, ndër të tjera, i theksoi palës britanike rëndësinë e një shpërndarjeje të balancuar të mundësisë së gjyqtarëve për të përfituar nga kjo nismë e rëndësishme për formimin e tyre profesional.



21 NËNTOR 2024

Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi priti në një takim pune z. Martin Mata dhe z. Aleksandër Sarapuli, bashkë-drejtorët ekzekutiv të Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF).

Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi mbi zbatimin e Memorandumit të Mirëkuptimit të nënshkruar mes Këshillit dhe AADF më 21.01.2021, përmes të cilit Këshilli angazhohet të jetë pjesë e institucioneve pritëse në kuadër të programit LEAD Albania. Program ky, i cili i mundëson profesionistëve të rinj, një përvojë të drejtpërdrejtë të zhvillimit të aftësive drejtuese, pranë institucioneve kryesore në vend. Gjatë këtij takimi u prezantua edhe këshilltari i përzgjedhur në kuadër të këtij programi, i cili do të atashohet Kabinetit për një periudhë 1 vjeçare.



Z. Rusi vlerësoi nismën e AADF për t'ju ofruar mundësinë të rinjve të talentuar dhe të përzgjedhur, që të bëhen pjesë e qeverisjes së gjyqësorit përmes ideve dhe kontributit të tyre. Nga ana tjetër, për Këshillin kjo do të thotë fuqizim të kapaciteteve përmes eksperiencës dhe praktikave të profesionistëve të përgatitur sipas modelit amerikan.

27 NËNTOR 2024

Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi priti në një takim pune, Drejtoreshën për Ballkanin Perëndimor në Drejtorinë e Zgjerimit pranë Komisionit Europian, znj. Valentina Superti, shoqëruar nga Shefja e Sektorit të Drejtësisë pranë Delegacionit të Bashkimit Europian, znj. Cinzia Tarletti.

Gjatë këtij takimi të pranishmit diskutuan mbi sfidat me të cilat po përballet aktualisht KLGJ, si organi qeverisës i pushtetit gjyqësor, siç janë vakancat e shkaktuara nga procesi vetting, çështjet e prapambetura si edhe mungesa e një sistemi të

integruar të menaxhimit të çështjeve. Po ashtu u diskutua edhe mbi transferimin e kompetencave të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, drejt KLGJ-së, me përfundimin e mandatit në dhjetor 2024.



Përfaqësueset e BE vlerësuan bashkëpunimin e deritanishëm dhe garantuan mbështetjen e tyre ndaj Këshillit, në lidhje me keto procese të rëndësishme.

Nga ana tjetër Z. Rusi shprehu vlerësimin e tij për asistencën e vazhdueshme të BE-së në realizimin e prioriteteve kryesore të Këshillit për të ardhmen, që siç janë evidentuar edhe nga gjetjet e Raportit të Progresit të Komisionit European për Shqipërinë, janë vijimi me prioritet i procesit të vlerësimit etik dhe profesional me qëllim ngritjet në detyrë të gjyqtarëve si edhe plotësimi i mëtejshëm i vakancave.

02 DHJETOR 2024

Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi, priti në një takim pune, në ambientet e Këshillit, Zëvendës Shefin e Misionit dhe Drejtuesin e Agjencisë Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim (SIDA), z. Erik Illes.

Z. Rusi gjeti rastin për të shprehur falenderime ndaj përfaqësuesve të SIDA për mbështetjen e tyre në lidhje me financimin e pjesshëm të ngritjes dhe vënies në funksion të Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësorë.

Gjatë takimit, palët diskutuam mbi disa aspekte teknike të bashkëpunimit, duke qenë se brenda muajit Dhjetor 2024 pritet disbursimi i parë i fondit të akorduar nga qeveria suedeze. Moment ky, i cili kurorëzon përpjekjet disa vjeçare të Këshillit për bërjen realitet të funksionimit të Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësorë, i cili do të mundësojë rritjen e efijencës dhe cilësisë së shërbimeve gjyqësore për qytetarët shqiptarë.

Të pranishmit u angazhuan për vijimin e bashkëpunimit dhe komunikimit për zbatimin me sukses të këtij projekti madhor për sistemin e drejtësisë dhe përdoruesit e gjykatave sipas parashikimeve të Marrëveshjes së Bashkëpunimit, nënshkruar mes Këshillit dhe Agjencisë.




11 DHJETOR 2024

Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi, priti në ambientet e Këshillit, Drejtuesen e Zyrës së Këshilli të Europës në Tiranë, znj. Giulia Re.

Objekti i takimit ishte vijimi i bashkëpunimit me fokus rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve gjyqësore për përdoruesit e gjykatave përmes përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe mjeteve online.

Gjatë diskutimit, bashkëbiseduesit u ndalën në mënyrë konkrete tek nevoja për mirë- administrimin e statistikave gjyqësore si dhe digjitalizimin e shërbimeve gjyqësore. Përdorimi i gjerë i instrumenteve teknologjike, tashmë të pilotuara nga KLGJ falë bashkëpunimit me Këshillin e Europës, siç janë platforma e njoftimeve elektronike dhe matja e nivelit të kënaqësisë së përdoruesve të gjykatës në lidhje me aspektet kyçe të shërbimeve gjyqësore, në të gjitha gjykatat e vendit kanë qëllim të evitojnë zvarritjet në gjykim si edhe të rrisin përgjegjshmërinë e administratës gjyqësore dhe të forcojnë besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

Të pranishmit u dakordësuan për konsolidimin e bashkëpunimit në vijim, në lidhje me sfidat kryesore me të cilat përballet KLGJ si edhe mbi mekanizmat për adresimin e tyre.



12 DHJETOR 2024



Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi mikpriti pranë ambienteve të Këshillit një përfaqësi me studentë të Fakultetit Juridik pranë Universitetit të Prishtinës, Kosovë.

Gjatë këtij takimi, të organizuar në formën e një bashkëbisedimi, juristët e ardhshëm nga Kosova patën mundësi që të njihen me rolin, funksionet dhe kompetencat e Këshillit, si organi qeverisës i sistemit gjyqësor. Po ashtu z. Rusi i prezantoi ata me hapat e ndërmarra nga ana e Këshillit, në kuadër të Reformës në Drejtësi, si edhe me sfidat dhe prioritetet në vijim, në funksion të një gjyqësori të pavarur dhe të besueshëm për publikun.

Gjatë këtij takimi, u vlerësua shkëmbimi i përvojave të ngjashme mes dy vendeve fqinje, si një mundësi e vlefshme për të rinjtë që të zhvillohen si profesionistë të aftë dhe me integritet.

Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi mori pjesë në konferencën me titull “7 vite rivlerësim kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Kjo konferencë, u bashkë-organizua nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Institucioni i Komisionerëve Publikë, në përfundim të mandatit të tyre kushtetues, si dhe përmbylljes me sukses të procesit të rivlerësimit kalimtar për 805 subjekte, gjyqtarë, prokurorë e ndihmës ligjorë.



Pjesë e panelit të kësaj konference ishin: znj. Vanhorn, e ngarkuara me punë e Ambasadës së SHBA-ve, z. Gonzato, Ambasadori i BE-së, z. Çomo, Kryetari i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, z. Dumani, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, si dhe z. Fejzulla, anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Rusi, si pjesë e panelit të kësaj konference, gjatë fjalës së tij shprehu vlerësimin për punën e gjithë aktorëve që morën pjesë në përfundimin e një procesi kaq të rëndësishëm, si dhe kontribuan në atë që sistemi gjyqësor është aktualisht, me një të ardhme të projektuar drejt integritetit të vendit në Bashkimin Europian. Z. Rusi theksoi angazhimin maksimal të treguar nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke ndërvepruar në mënyrë të shpejtë dhe cilësore me të gjithë aktorët e përfshirë gjatë gjithë kohëzgjatjes së këtij procesi.

Në përmbyllje të ndërhyrjes së tij, z. Rusi garanoi se KLGJ zotëron të gjitha kapacitetet ligjore, administrative dhe profesionale për ta vijuar këtë proces duke u udhëhequr nga parimet e efektivitetit, profesionalizmit dhe transparencës. Ky takim mbledhi së bashku përfaqësues të institucioneve të drejtësisë, trupit diplomatik, aktorë të reformës në drejtësi, si dhe partnerë ndërkombëtarë për të diskutuar mbi sfidat me të cilat janë përballur organet e vettingut, si dhe të ardhmen e këtij procesit, si pjesë e reformës në drejtësi.

Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor zhvilloi pranë ambienteve të Këshillit, një takim me ambasadorin e ri të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Tiranë, z. Michel Tarran.

Gjatë këtij takimi, z. Rusi gjeti rastin të shprehte vlerësimin e tij rreth mbështetjes së vazhdueshme të ofruar nga prezenca e OSBE ndaj Këshillit, kryesisht e fokusuar në drejtim të forcimit të kapaciteteve dhe përmirësimit të transparencës, efijencës dhe rritjes së cilësisë.

Tarran vlerësoi përpjekjet dhe arritjet e dëshmuara nga Këshilli për një gjyqësor efikas dhe transparent në funksion të kthimit të besimit të publikut tek sistemi gjyqësor. Të pranishmit në përfundim të takimit, u dakordësuan mbi intensifikimin e mëtejshme të bashkëpunimit.




- Këshilli në datën 22.10.2024 deklaroi mbarimin e mandatit dhe përfundimin e qëndrimit në detyrë të anëtares së Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami, dhe zëvendësimin e saj me anëtares e re, Znj. Violanda Theodhori e zgjedhur nga Kuvendi i Shqipërisë si përfaqësuese e shoqërisë civile. Duke qenë se znj. Llagami mbante funksionin e kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor me përfundim e mandatit të saj, Këshilli në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi vendosi zgjedhjen e z. Ilir Rusi, Kryetar të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Gjithashtu vendosi zgjedhjen me shumicë votash të znj. Yllka Rupa, në funksionin e zëvendëskryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Këshilli miratoi vendimin për rritjen e numrit të gjyqtarëve nga 13 në 22 në Gjykatën Administrative të Apelit dhe numrin e përgjithshëm të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë nga 408 në 417.
- Këshilli po ashtu miratoi programin e vlerësimit etik dhe profesional për vitin 2025 si dhe miratoi programin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor për vitin 2025.
- Në kuadër të procesit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve si dhe atij të ngritjes në detyrë, Këshilli gjatë 3 mujorit të katërt 2024 vendosi miratimin e raporteve të vlerësimit etik dhe profesional, për 2 gjyqtarë për periudhën 2017-2019 dhe për 4 gjyqtarë për periudhën e vlerësimit 2013-2016 si edhe për 1 gjyqtare të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për periudhën 02.03.2020 – 14.06.2023.
- Këshilli miratoi vendimin për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për 1 (një) kandidat.
- Këshilli miratoi gjatë periudhës raportuese 2 ngritje në detyrë, më saktësisht znj. Elvana Çiçolli në Gjykatën Administrative të Apelit dhe znj. Anila Karanxha në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
- Këshilli vendosi hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për 20 (njëzet) pozicione të lira, konkretisht 12 (dymbëdhjetë) pozicione të lira në fushën e të drejtës civile dhe 8 (tetë) pozicione të lira në fushën e të drejtës penale.
- Këshilli vendosi fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 635, nr. 636, datë 31.10.2024 dhe për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 647, nr. 654, datë 31.10.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Këshilli vendosi kualifikimin dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për 8 (tetë) kandidatë dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, për 4 (katër) kandidatë.
- Këshilli vendosi përfundimin e procedurave të ngritjes në detyrë në: Gjykatën e Lartë për 1 (një) kandidat; Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për 18 (tetëmbëdhjetë) kandidatë, Gjykatën Administrative të Apelit për 1 (një) kandidat dhe në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar për 1(një) kandidat.
- Këshilli vendosi caktimin në skemë delegimi të 2 gjyqtarëve, konkretisht znj. Etleva Gjamo dhe znj. Selvie Gjoçaj, pranë Gjykatës Administrative të Apelit.
- Këshilli vendosi për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për:
 - 1 (një) pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës;
 - 1 (një) pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
- Në fokus të veprimtarisë së tij gjatë këtyre muajve Këshilli ka pasur edhe procesin e plotësimit të vakancave, duke vendosur për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të 2 (dy) gjyqtarëve.

- Këshilli miratoi vendimet për kualifikimin dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Durrës dhe Elbasan për 9 (nëntë) kandidatë.
- Këshilli miratoi vendimin për fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
- Këshilli miratoi vendimin për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të shpallur me vendimin nr. 83, datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim.
- Këshilli shqyrtoi dhe miratoi vendimet përkatëse për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 80 dhe nr. 81 datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Këshilli vendosi për transferimin e gjyqtarës znj. Olkeda Lice në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
- Gjithashtu, Këshilli vendosi skualifikimin e një kandidati nga procedura e lëvizjes paralele, për pozicionin nr. 240, datë 02.05.2024 si dhe skualifikimin dhe përjashtimin e tij nga procedura e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
- Këshilli vendosi përfundimin e procedurave të lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për 11 (njëmbëdhjetë) kandidatët referuar kërkesave të tyre të përcjella në Këshill.
- Këshilli në përfundim të procedurave të verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidatëve për magistratë, profili gjyqtar, të diplomuar në Shkollën e Magistraturës për vitin akademik 2023-2024 vendosi emërimin dhe caktimin në pozicion për 32 gjyqtarët e emëruar më datë 31.07.2024, si më poshtë:
 1. Z. Xhulio Doku në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan;
 2. Z. Boiken Bendo në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan;
 3. Z. Delvijot Llusha në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë;
 4. Znj. Irma Cacaj në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë;
 5. z. Ertil Meçaj në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë;
 6. Znj. Elira Hroni në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier;
 7. Znj. Erola Tarelli në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier;
 8. Z. Bevil Beqiraj në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë;
 9. Znj. Aurora Tusha në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier;
 10. Znj. Iva Bregasi në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier;
 11. Znj. Amantja Levanaj në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier;
 12. Znj. Eni Naqellari në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër;
 13. Z. Uran Korra në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë;
 14. Znj. Teftë Xhanari në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër;
 15. Znj. Anisa Xake në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë;
 16. Z. Enri Rista në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër;
 17. Z. Renis Bega në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat;
 18. Znj. Irida Barkaj në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër;
 19. Znj. Besmira Arshiaj në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës;
 20. Znj. Matilda Çela në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës;
 21. Z. Ervis Koxhaj në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat;
 22. Znj. Megi Anxhela Muhaj në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibrë;

23. Znj. Eda Gjovari në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë;
24. Znj. Orinda Lloshi në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë;
25. Z. Mexhit Doçi në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë;
26. Znj. Esmeralda Shehu në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë;
27. Znj. Flutura Çuko në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër;
28. Znj. Arxheina Shkopi në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër;
29. Znj. Ermira Bushi në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë;
30. Znj. Dorinela Nikolli në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë;
31. Z. Suzan Bushi në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë;
32. Znj. Valjona Haxhiraj në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

- Këshilli vendosi për kualifikimin për në programin e formimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, viti akademik 2024 – 2025, për 14 (katërmëdhjetë) kandidatë fitues si dhe skualifikimin e 1(një) kandidati, për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, për vitin akademik 2021-2022.
- Këshilli miratoi konfirmimin e znj. Iva Zemani si “ndihmësmagjistrate”, në Gjykatën e Lartë dhe zgjatjen e mandatit të komandimit me 1 (një) vit.
- Më tej, Këshilli vendosi kualifikimin e një gjyqtareje për t’u komanduar në pozicionin Inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe me pas vendosi dërgimin e emrit të saj për t’u komanduar inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
- Këshilli vendosi për përsëritjen e komandimit të gjyqtarit z. Gentjan Jahjollli në pozicionin këshilltar juridik në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.
- Këshilli miratoi vendimin për komandimin e gjyqtarës znj. Kostandina Kuro në pozicionin e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin, në Njësinë e Vlerësimit Etik dhe Profesional të Gjyqtarëve, në Këshillin e Lartë Gjyqësor.
- Këshilli vendosi caktimin e një gjyqtari në pozicionin e Këshilltarit për Etikën në Këshillin e Lartë Gjyqësor.
- Këshilli vendosi për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. Aida Metushi, znj. Reda Vathi, znj. Andiola Turtulli, në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, si dhe të znj. Anida Bici, z. Besmir Lesaj, znj. Klodiana Bytyçi, z. Lulzim Karini në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit.
- Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve fitues në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për ndihmës ligjorë, viti akademik 2024-2025.
- Këshilli vendosi caktimin e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në Bordin Drejtues të Qendrës së Teknologjisë për sistemin e drejtësisë.
- Në përputhje me detyrimet ligjore, Këshilli miratoi listën e gjyqtarëve kandidatë për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, për vitin 2025.
- Në përmbushje të detyrimeve ligjore, si organ përgjegjës për mbarëvajtjen e marrëdhënieve të gjyqësorit me publikun, Këshilli caktoi znj. Dorina Stroka, gjyqtare për median pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, znj. Orinda Lloshi pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë dhe znj. Gentiana Shukullari në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.



Me qëllim ruajtjen e integritetit gjyqësor, gjatë kësaj periudhe, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vijuar me shqyrtimin e procedimeve disiplinore dhe ka konkluduar me dhënien e vendimeve, konkretisht:


- Me vendimin nr. 606, datë 16.10.2024 është vendosur përfundimi i procedimit disiplinor nr. 3/2022 të filluar ndaj ish magjistratit z. {...}, pa një vendim përfundimtar;
- Me vendimin nr. 607, datë 16.10.2024 është vendosur përfundimi i procedimit disiplinor nr. 1/2023 të filluar ndaj ish magjistratit z. {...}, pa një vendim përfundimtar;
- Me vendimin nr.608, datë 16.10.2024 është vendosur përfundimi i procedimit disiplinor nr. 2/2023 të filluar ndaj ish magjistratit z. {...}, pa një vendim përfundimtar;
- Me vendimin nr. 609, datë 16.10.2024 është vendosur përfundimi i procedimit disiplinor nr. 1/2024 të filluar ndaj ish magjistrates znj. {...}, pa një vendim përfundimtar;
- Me vendimin nr.730, datë 05.12.2024 (të ndryshuar me vendimin nr. 745, datë 13.12.2024) është vendosur shfuqizimi i vendimit nr. 463 datë 11.10.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistrates znj. {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Tiranë" dhe vijimin e shqyrtimit të tij;
- Me vendimin nr.731, datë 05.12.2024 (të ndryshuar me vendimin nr. 746, datë 13.12.2024) është vendosur shfuqizimi i vendimit nr. 494 datë 25.10.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratëve z. {...} dhe z. {...}, me detyrë gjyqtarë në Gjykatën e {...}" dhe vijimin e shqyrtimit të tij;
- Me vendimin nr.759, datë 23.12.2024 është vendosur caktimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates znj. {...}, me funksion gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm {...}.

Me qëllim plotësimin e trupave gjyqësore, Këshilli i Lartë Gjyqësor trajtoi 10 kërkesa për caktimin e 17 gjyqtarëve të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme.

KLJGJ, në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit, gjatë kësaj periudhe, ka trajtuar 7 kërkesa për informacion, të ardhura si përmes postës elektronike ashtu edhe në rrugë zyrtare, të cilat morën përgjigje brenda një afati të arsyeshëm.

Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun me Jashtë dhe Botimet ka trajtuar 130 shkresa të cilat janë paraqitur nga qytetarë, organizata dhe institucione publike dhe jopublike.

Veprimtaria e KLGJ-së (Tetor -Dhjetor 2024):



- 19 mbledhje plenare
- 221 akte të miratura në ndihmë të të gjithë sistemit gjyqësor, më konkretisht:
 - 35 akte kolektive, Tetor 2024
 - 9 akte kolektive, Nëntor 2024
 - 4 akte kolektive, Dhjetor 2024
 - 84 akte individuale, Tetor 2024
 - 22 akte individuale, Nëntor 2024
 - 55 akte individuale, Dhjetor 2024

Pjesa tjetër përfshihen 12 rregulla të brendshme.



KLGJ FACEBOOK

Ndjekës në total

2615

-na ndiqni-

Adresa: Godina “Poli i Drejtësisë”, Rruga”Ana Komnena”, Tiranë

www.klgj.al

email: kontakt@klgj.al